


# MILIONA PËR CENT

Monitorimi i Prokurimit  
Publik në Agjencinë  
Qëndrore të Prokurimit

2018








# MILIONA PËR CENT

Monitorimi i Prokurimit  
Publik në Agjencinë  
Qëndrore të Prokurimit

2018



COPYRIGHT © 2018.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE</b>	<b>6</b>
<b>DEFINICIONE TË TERMEVE KRYESORE</b>	<b>7</b>
<b>PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME</b>	<b>9</b>
<b>HYRJE</b>	<b>11</b>
<b>METODOLOGJIA</b>	<b>12</b>
<b>TRANSPARENCA</b>	<b>13</b>
<b>VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI</b>	<b>15</b>
<b>SPECIFIKAT TEKNIKE DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME</b>	<b>23</b>
<b>VLERËSIMI I OFERTAVE</b>	<b>30</b>
<b>ZBATIMI I KONTRATËS, MONITORIMI I PERFORMANCËS DHE PAGESAVE</b>	<b>40</b>
<b>KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME</b>	<b>43</b>
<b>REKOMANDIME</b>	<b>44</b>
REKOMANDIMET PËR INSTITUCIONIN KONTRAKTUES	44
REKOMANDIMET PËR KOMISIONIN RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK	44
REKOMANDIMET PËR ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT	45



# LISTA E SHKURTESAVE

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
DT	Dosja e Tenderit
EU	European Union
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OE	Operator Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
TI	Transparency International
UA	Udhëzues Administrativ
ZKA	ZKA Zyra Kombëtare e Auditimit
ZP	Zyrtar i Prokurimit
ZK	Zyra e Kryeministrit





# DEFINICIONE TË TERMEVE KRYESORE

TERMI	DEFINICIONI	SHEMBULL
Akciza për litër	Tatim, i një lloji të veçantë, që aplikohet mbi prodhimet e vendit dhe mbi produktet e importuara	Taksë e veçantë që aplikohet për çdo litër të derivatit të importuar.
Artikuj të përdorimit të përbashkët	Prodhimi ose shërbimi i kërkuar nga një ose më shumë autoritete kontraktuese, për të cilat mund të arrihet përdorimi më efikas dhe me kosto ekonomike e fondeve publike me anë të zhvillimit të prokurimit qendror, të përbashkët ose të konsoliduar.	Nafta, letra, ushqimet, riparimi i automjeteve.
Berza mesatare mujore	Kalkulimi i mesatares të gjitha çmimeve mujore të berzës.	
Çmim jo normalisht i ulët	Çmimi i tenderit kur kosto ekonomike e procesit të prodhimitarisë dhe e shërbimeve të ofruara është më e lartë se ajo e ofruar. Kjo rrezikon moszbatimin e tenderit.	Kur çmimi i artikullit ofrohet me çmim më të ulët sesa kostoja e prodhimit. Për shembull dritare me kornizë me pesë euro
Çmimi për faturim	Çmimi final duke i përfshirë të gjitha taksat dhe komponentët shtesë, të cilin duhet ta paguajë konsumatori	
Dosje e Tenderit	Dokument në të cilin përshkruhen kushtet dhe kriteret për shpërblim me kontratë	
Furnizues / Furnitor	Operatori Ekonomik që është kontraktuar të ofroj një shërbim apo produkt	
Kursi mesatar mujor	Kalkulimi i mesatares të gjitha kurseve valutore mujore.	
Llot	Tender i ndarë në pjesë	Tenderimi i 30 llojeve të barnave esenciale, në një procedurë të vetme tenderuese
Maune	Mjet për transportimin e naftës	



MILIONA PËR CENT

|||||

Njoftim për dhënie të kontratës	Njoftim përmes të cilit shpallet fituesi i një procedure tenderuese, në të cilën përfshihet çmimi dhe kontaktet e kompanisë	
Njoftim për Kontratë	Njoftim për shpalljen e tenderit në Ueb Faqen e KRPP	
Operator Ekonomik	Furnizues, ofrues i shërbimeve ose kontraktues i punëve	
Paramasa	Parallogaritja e nevojave për artikuj të caktuar ose punë, në tenderët me çmime për njësi	
PLATTS	Kompani për konsulta për çmimin e karburanteve dhe energjisë	Çmimi i naftës sipas mesatares mujore
Premium	Premium nënkupton marzhën e fitimeve të kompanisë për çdo litër naftë	0.0001 euro për çdo litër naftë që i shitet institucionit
Premiumi i rafinerisë	Fitimi i rafinerisë në shitjen e naftës, zakonisht për ton.	
Raport i Vlerësimit	Raport të cilin e përgatitë Komisioni për vlerësimin e ofertave, i cili i dorëzohet zyrtarit kryesor të prokurimit, në formë të rekomandimit	
Siguria (garancia) e ekzekutimit	Dokument me të cilin kompania garanton përfundimin e suksesshëm të kontratës	Depozita bankare, apo siguria e tenderit përmes kompanive të sigurimit

|||||





# PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport paraqet të gjeturat nga analizimi i aktivitetit të prokurimit të centralizuar, të ndërmarrë nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) në emër të 71 Autoriteteve Kontraktuese (Institucione Publike Lokale, Qendrore dhe Kompani Publike) në kuadër të kontratës trevjeçare "kornizë" për furnizim me karburante të këtyre institucioneve.

Hulumtimi është bazuar në zbatueshmërinë e legjislacionit të prokurimit publik nga AQP-ja, nga faza e planifikimit të aktivitetit prokurues deri te faza e zbatimit të kontratës së lartcekur. Gjithashtu, është vlerësuar roli dhe impakti i vendimeve nga akterët e përfshirë në këtë aktivitet: AQP-së si inicues dhe menaxhues i aktivitetit të prokurimit, OSHP-së si organ i pavarur shqyrtues i ligjshmërisë së vendimeve, KRPP-së, si institucion mbikqyrës i prokurimit dhe AK-ve si shfrytëzues të kësaj kontrate.

Të gjeturat e këtij hulumtimi shpërfaqin veprime institucionale që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me praktikatat e mira të prokurimit, siç janë: mangësit në planifikim të aktivitetit të prokurimit, kritere diskriminuese në tenderim, vonesat e shumta deri të nënshkrimit të kontratave si pasojë e ankesave të shumta, dhënia e kontratave me çmime jonormalisht të ulëta dhe monitorimi joefektiv i zbatimit të kontratave.

Njoftimi për kontratë për këtë tender ishte shpallur në muajin dhjetor 2016 për të zgatur procesi i prokurimit deri në muajin korrik 2018, kur edhe është nënshkruar kontrata për Lot-in e 5-të (i ritenderuar), e fundit nga 6 Lot-et, sa ishin gjithsej në këtë tender. Prosesi i tejzgatur ishte pasojë e ankesave të shumta nga tenderuesit kundrejt vendimeve të AQP-së, përmes së cilave këta të fundit kishin shfaqur pakënaqësitë në lidhje me vlerësimin e tenderëve sipas disa kritereve të pabazuara ligjore të vendosura në dosjen e tenderit, ku disa nga këto pretendime ankimore më vonë ishin cilësuar nga OSHP-ja si të bazuara.

Ankesat kishin të bënin edhe me dhënien e kontratave me çmime jonormalisht të ulëta, ku operatorët ekonomik ankues kishin deklaruar se dhënia e këtyre kontratave është në kundërshtim me Nenin 61 të LPP-së dhe rregulloreve përkatëse për tenderët jonormalisht të ulët, dhe si e tillë do të duhej të refuzohej nga AQP-ja. OSHP-ja kishte vërtetuar dhënien e këtyre kontratave, përkundër konstatimeve të ekspertit shqyrtues se këta tender janë normalisht të ulët dhe lënda duhet të kthehet në rivlerësim.

Dhënia e kontratave me çmime jonormalisht të ulëta është e rrezikshme për autoritetin kontraktues dhe për interesin publik në përgjithësi. Tenderët jonormalisht të ulët mund të dështojnë, posaqërisht në rastet kur një operator ekonomik ka keqkuptuar kompleksitetin e realizimit të kontratës apo nuk ka marrë parasysh të gjitha kostot dhe rreziqet e prokurimit. Autoriteti Kontraktues pastaj është i obliguar që përsëri të shpallë tender për kontratën e njejtë duke humbur kohë dhe kosto shtesë administrative. Rrezik tjetër është se furnizimet mund të jenë të një kualiteti më të ulët sesa furnizimet që do të duhej të ofroheshin sipas kushteve të kontratës. P.sh një operator ekonomik me qëllim të uljes së humbjeve që sjellë implementimi i kontratave me çmime jonormalisht të ulëta mund të tentojë ta mashtrorë Autoritetin Kontraktues dhe të ofrojë furnizime me cilësi më të ulët. Në një tender jo normalisht të ulët po ashtu ekziston rreziku që të shkelen ligjet dhe rregulloret e punës. Një operator ekonomik do të tentojë të mos paguajë taksat, të paguajë punëtorët nën pagën minimale, mos të respektojë oraret e punës etj. Si pasojë, tregu do të çrregullohet dhe kompanitë serioze do të dekurajohen në ofertimin për kontrata publike. Në terma afatgjatë, konkurrenca ulet, sepse një numër i vogël i firmave ofertojnë në prokurimet publike dhe si pasojë çmimet mund të rriten.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Sigma (2016), *Abnormally Low Tenders*, OECD Publishing, Paris





AQP-ja, përpos përzgjedhjes së operatorëve ekonomik kishte edhe rolin e monitoruesit të implementimit të kontratës, e cila është një nga fazat shumë të rëndësishme në procesin e prokurimit. Monitorimi i kontratës nuk ishte lënë në nivel të AK-ve, mirëpo AQP-ja kishte vendosur sistem të monitorimit në nivel të përgjithshëm, e që edhe pas 9 muajve të fillimit të kontratës, AQP-ja ende nuk kishte filluar ta zbatojë, duke mos pranuar raporte 6 mujore nga operatorët ekonomik për sasitë, llojin dhe çmimin e karburanteve të furnizuar tek AK-të, ashtu siç parashihet në kushtet e kontratës me operatorët ekonomik.

Me qëllim të eliminimit të problemeve nga dhënia e kontratave me çmime jo-normalisht të ulëta, KDI-ja rekomandon që AQP-ja të trajtojë kujdesshëm tenderët jonormalisht të ulët. Neni 61 i Ligjit të Prokurimit Publik sqaron si duhet vepruar kur AK-ja hasë në tenderë jonormalisht të ulët, "AK-ja pas marrjes parasysh të sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi, do të vendos nëse këto sqarime janë të mjaftueshme për dhënie apo për anulim", pra nëse vërtetohet se tenderi është jonormalisht i ulët, AK-ja do ta refuzojë tenderin. Ky rregull, lejon autoritetin kontraktues që të shmang pasojat negative të kontratave me çmimeve jonormalisht të ulëta. Në mënyrë që të mbrohet interesi publik kundër rrezikut të performancës së ulët apo jo performancës të këtyre kontratave, këto rregulla gjithashtu mundësojnë konkurrencë të drejtë në mes operatorëve ekonomik duke reduktuar përparësite jo fer.

KDI-ja rekomandon që më qëllim ngritjes së cilësisë së vendimeve, OSHP-ja të trajtojë kujdesshëm konstatimet e Ekspertit Shqyrtues, provat në dispozicion dhe argumentet e sjella nga palët pjesëmarrëse në procedurë. Gjithashtu rekomandohet që edhe KRPP-ja si institucion mbikqyrës i prokurimit në Kosovë, të jetë më proaktiv në vëzhgimin e aktiviteteve të prokurimit ku trajtohen tenderët jonormalisht të ulët, si një dukuri mjaft e përhapur, sidomos tek kontratat e furnizimit me karburante dhe të ofrojë një opinion të përgjithshëm mbi këtë çështje që do eliminonte mundësitë e përsëritjes së problemeve të ngjashme në të ardhmen.



# HYRJE

Kontratat e prokurimit publik përbëjnë një pjesë të madhe të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe të shpenzimeve publike të çdo vendi, dhe si të tilla paraqesin një pikë shumë të ndjeshme dhe të ekspozuar ndaj manipulimeve dhe keqmenaxhimeve. Kontratat publike shfrytëzohen për blerjet të ndryshme për nevoja të publikut, duke filluar nga një laps i thjeshtë apo uji për pijë, e deri te ndërtimi i autostradave apo kontraktimi i shërbimeve të ndjeshme shtetërore. Si të tilla gjenerojnë një qarkullim të madh të parasë, dhe nëse janë të menaxhuara mirë, janë një indikator kyç në zhvillim e sektorit të biznesit.

Më 2017, pjesa e prokurimit publik në BPV, në buxhetin e Kosovës arriti në 7.35 %, me vlerë prej 459.7 milionë eurosh. Prej këtyre mjeteve, 87% janë kontraktuar përmes procedurës së hapur. Sidoqoftë, 98% e kontratave publike janë dhënë sipas kriterit të çmimit më të ulët, e jo sipas raportit më të mirë çmim/cilësi.<sup>2</sup>

Një menaxhim i dobët i prokurimit publik parandalon zhvillimin e mirëfilltë të konkurrencës së tregut, duke krijuar kështu mundësi favorizuese për operator ekonomik të caktuar. Më tepër, duke paguar më shtrenjtë për shërbimet dhe mallrat sesa që janë në tregun me pakicë, humb "vlera për paranë", respektivisht rriten shpenzimet publike, duke ndikuar negativisht në burimet, apo investimet e kthyer nga Qeveria për tatimpaguesit. Arsyeja e themelimit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, ishte që të arrihet kursimi i fondeve publike përmes prokurimeve të centralizuara. Synohej që përmes lidhjes së kontratave me vlerë më të madhe të sigurohej kosto më e ulët për njësi. Për shkak të numrit të madh të Autoriteteve Kontraktuese të përfshira dhe vlerës së lartë të kontratave të centralizuara, është shumë e rëndësishme që AQP-ja, përmes aktiviteteve të centralizuara ta arrijë vlerën për paranë e shpenzuar. Sigurimi i çmimeve më të favorshme dhe kursimi i parasë publike vetëm, nuk e garantojnë vlerën për paranë, pa një monitorim efektiv të zbatimit të kontratave publike. Vetëm duke kryer një monitorim sistematik dhe efikas do të mund të parandalohet keqmenaxhimi, korrupsioni dhe të sigurohej që sjellja e korruptuar të ekspozohet dhe sanksionohet.

Monitorimi 8 vjeçar i prokurimit publik në nivel qendror dhe lokal nga KDI-ja, tregon arsyet pse ky sektor është më i korruptuar dhe keqmenaxhuar brenda institucioneve publike të Kosovës. Arsyet janë: dispozitat ligjore të pamjaftueshme, mungesa e trajnimeve adekuate për stafin e prokurimit publik, planifikimet e dobëta, mungesën e vullnetit të mirë dhe integritetit të zyrtarëve kyç në vendimmarrje, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies e posaçërisht me mosndëshkueshmërinë e akterëve të përfshirë në keqmenaxhim. Blerja e derivateve të naftës për nevoja të institucioneve publike vazhdon të jetë problematike. Institucionet publike shpesh kanë dështuar në sigurimin e një çmimi të arsyeshëm, duke paguar kështu mbi vlerën e tregut me pakicë, por edhe duke blerë me çmime të ndryshme, ndonëse në hapësira të njëjta gjeografike. Rezultatet e monitorimit të kontratës kornizë, e cila është objekti i këtij hulumtimi e vënë në theks impaktin e vendimeve të akterëve të përfshirë në procesin e prokurimit në ofrimin e hapësirës për zhvillim të ndërmarrjeve private, pasi roli i prokurimit publik është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e bizneseve duke ju ofruar burime të të hyrave të sigurta për një periudhë kohore.

Sipas vlerësimit të KDI-së, ky aktivitet i prokurimit nuk ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e bizneseve siç parashihet me Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik 2017-2021, pasi vlera prej 11,482,789.28. Euro për kontratat e nënshkruara për LOT 1,2,3 dhe 5, ka mundur që bizneset të realizojnë një fitim prej vetëm 6,083.79 Euro (ose 0.05% të vlerës së kontratës). Duke i përlogaritur edhe kostot e tjera që këto biznese kanë, del që ato operojnë me humbje, që është në kundërshtim me rolin e prokurimit publik në zhvillimin ekonomik kombëtar.

Qëllimi i këtij raporti është që të analizoj procedurat e tenderimit dhe dhënies së kontratës AQP-17-001-1-1-1, monitorimin e zbatimit të kontratës, adresimn e gjetjeve si dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e politikave dhe praktikave aktuale në mënyrë që të përmirësohet Prokurimi Publik jo vetëm në AQP, por edhe institucionet tjera.



# METODOLOGJIA

Ky hulumtim është zhvilluar duke u bazuar në dy kategori hulumtuese: kuantitative dhe atë kualitative. Sipas metodës kuantitative janë analizuar sasitë e kërkuara dhe çmimet e ofruara nga Operatorët Ekonomik për kontratën e AQP-së për furnizim me derivate për 71 Autoritete Kontraktuese. Këto të dhëna trajtojnë natyrën e kërkesës dhe problemet e konkurrencës dhe arsyeshmërinë e çmimeve të operatorëve ekonomik me qëllim të realizimit të suksesshëm të kësaj kontrate. Metoda kualitative analiza trajton pesë (5) faza të prokurimit: vlerësimin e nevojave dhe planifikimit, përgatitjen e specifikacioneve teknike, vlerësimin e ofertave, zbatimin e kontratës dhe monitorimin e performancës, dhe fazën e auditimit dhe përmbylljes. Përpos tyre, kjo metodologji trajton nivelin e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit të Operatorëve Ekonomik (OE), si dhe ankesat e deponuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe vendimet e marra nga ky organ.

Kjo metodologji e hulumtimit dhe monitorimit në prokurimin publik është një nga praktikatat të cilat përdoren gjerësisht nga organizatat mbikëqyrëse dhe kryesisht nga degët e "Transparency International", nëpër shtete të ndryshme. Përparësi kryesore e kësaj metodologjie është fakti se është gjithëpërfshirëse dhe nuk anashkalon asnjë nga fazat e prokurimit. Rëndësi të posaçme i është dhënë bashkëpunimit me operatorët ekonomik, përkatësisht bizneset të cilat janë në marrëdhënie kontraktuale me Autoritetin Qendror të Prokurimit.

Dokumentet të cilat janë përdorur gjatë ekzaminimit të tenderëve kanë qenë: raportet e vlerësimit të tenderëve, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontrata, dosjet e tenderit, ofertat e operatorëve ekonomik, kontratat publike, vendimet e OSHP-së, raportet e ekspertizës, ankesat e operatorëve. Monitorimi aktiv i projektit do të përmirësoj performancën e përgjithshme të institucioneve me buxhet/rrezik të lartë, si dhe përfshirja e akterëve të ndryshëm në këtë proces do të sjell përfitime për të gjitha palët e përfshira në proces. Pjesëmarrësit nga komuniteti i biznesit (të cilët nuk e kanë fituar tenderin), OJQ-të, gazetarët e mediave hulumtuese, anëtarët e Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, Autoritetet Kontraktuese, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, si dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm do të kenë mundësinë të përfitojnë nga njohuritë e KDI-së të fituara ndër vite.



# TRANSPARENCA

Monitorimi i kësaj kontrate shërben gjithashtu edhe si mjet për matjen e transparencës së AQP-së dhe autoriteteve kontraktuese shfrytëzuese të kësaj kontrate. KDI-ja ka dorëzuar 50 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe ka pranuar 25 përgjigje ndaj këtyre kërkesave. Institucionet që nuk janë përgjigjur janë disa nga autoritetet lokale të përshkruara në tabelën si më poshtë.




























KDI-ja, gjithashtu ka zhvilluar intervista, takime, biseda telefonike me zyrtarët e AQP-së, zyrtarët e e Institucioneve Publike, operatorë ekonomik , ku të gjithë kanë shfaqur gatishmëri dhe vullnet për përgjigje dhe bashkëpunim rreth procesit të monitorimit të kësaj kontrate.

**Tabela 1.0 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike të dërguara dhe atyre të pranura**

AQP	3	3
OSHP	2	2
KK Drenas	1	1
KK Fushë Kosovë	1	1
KK Graçanice	1	1
KK Lipjan	1	1
KK Obiliq	1	1
KK Podujeve	1	
KK Prishtine	1	1
Shërbimi i Shëndetit Mendor Prishtine	1	
Qendra e Kosovës për Transfuzionin e gjakut	1	1
Hortikultura Prishtinë	1	1
IKSHPK- Prishtine	1	
Qendra e Mjekësisë Urgjente	1	1
Qendra kryesore e mjekësisë familjare Prishtinë	1	1
Trafiku Urban	1	1
Ministria e Tregtis dhe Industrisë	1	
Ministria e zhvillimit Ekonomik	1	1
KK Deçan	1	1
KK Gjakovë	1	

MILIONA PËR CENT

|||||

KK Istog		1
KK Junik		1
KK Klinë		1
KK Peje		1
Spitali Regjional Gjakove		1
Spitali Regjional Peje		1
Shërbimi i Shëndetit Mendor Gjakove		1
Shërbimi i Shëndetit Mendor Peja		1
Instituti i Mjekësisë së Punës Kosovë-Gjakovë		1
KRM Çabrati - Gjakove		1
KK Dragash		1
KK Malisheve		1
KK Prizren		1
KK Rahovec		1
KK Suhareke		1
KK Ferizaj		1
KK Hani i Elezit		1
KK Kaçanik		1
KK Shtime		1
Spitali Regjional Ferizaj		1
KK Gjilan		1
KK Kamenicë		1
KK Viti		1
KK Skenderaj		1
KK Vushtrri		1
Spitali Regjional Mitrovica		1
KRM "UNITETI" Mitrovicë		1

■ Numri i Kërkesave të dërguara    ■ Numri i Kërkesave të pranuar

|||||



|||||

Statistikave të Kosovës, i cili për muajin maj kur ky tender ishte shpallur ishte 1.02 Euro për litër të dieselit ndërsa 1.06 euro për litër të benzinës<sup>3</sup>. Gjatë fazës së planifikimit të prokurimeve, Autoritetet Kontraktuese kanë dështuar të marrin parasysh rreziqet lidhur me inflacionet dhe deflacionet në tregun e derivative. Si rezultat, në kohën e shpalljes së tenderit, dallimi ndërmjet vlerës së planifikuar dhe vlerës së tregut është mbi një milion euro ( $(1.06€ - 0.96€) = 0.06€ \times 16,740,000 \text{ litra} = 1,004,400€$ )

Nëse i analizojmë sasinë e parashikuara për blerje nga Autoritetet Kontraktuese në dosje të tenderit për produktin diesel për vetura (10ppm) për Lot 1, totali është 5,000,200 litra, ndërsa sasinë e paraqitura në dosje të tenderit në Listën e Çmimeve për të njëjtin LOT janë 5,100,200 litra<sup>4</sup>. Që nënkupton se diferenca prej 100,000 litra nuk parashihet të blihet nga asnjëri AK, mirëpo duket të jetë një gabim aritmetikorë. Pra sasinë e kontraktuar me operatorin ekonomik janë të mbivlerësuara për 100,000 litra. Kjo mund të sjellë rrezik në fazën e ekzekutimit të kontratës për shkak se kjo sasi edhe pse kontraktuar mund të mos blihet nga asnjëri nga Autoritetet Kontraktuese të Lot-it 1, për shkak se nuk është e planifikuar nga asnjëri nga AK-të për blerje.

**SIPAS FORMULARËVE** të dorëzuar nga Autoritetet Kontraktuese në AQP, sasia e parashikuar e karburanteve që do të blihet përmes këtijë tenderi për 3 vitet e ardhshme pritet të jetë 16.74 milion litra. Ndërsa vlera e parashikuar për blerjen e kësaj sasive është parashikuar 16.00 milion euro. Që nënkupton se çmimi i planifikuar për litër është 0.96 €/L.

3 Indeksi I Harmonizuar i çmimeve Maj 2018

4 Furnizim me karburante AQP 17-001-111 – Dosja e Tenderit

|||||



|||||

Numri rendorë	Emri i Autoritetit Kontraktues	Sasia e parashikuar për 36 muaj			
		Diesel për vetura dhe mjete tjera levizëse (10ppm)	Diesel per gjenerator (10ppm)	Diesel për ngrohje (10ppm)	Benzinë për vetura dhe gjeneratorë (10ppm)
1	KK Drenas	96,000	10,500	39,000	4,500
2	KK Fushë Kosovë	149,400	68,542	128,333	19,542
3	KK Graçanicë	70,000	564	48,333	48,333
4	KK Lipjan	240,000	24,000	93,333	9,333
5	KK Obiliq	36,000	-	4,583	2,750
6	KK Podujevë	307,800	8,500	-	21,000
7	KK Prishtinë	200,000	72,222	693,333	86,667
8	Shërbimi i Shëndetit Mendor Prishtinë	8,000	356	12,444	3,556
9	Qendra e Kosovës për Transfuzi- onin e gjakut	12,000	644	-	1,289
10	Hortikultura Prishtinë	102,000	1,722	-	10,333
11	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Prishtine	4,000	433	-	18,056
12	Qendra e Mjekësisë Urgjente	50,000	300	-	750
13	Qendra kryesore e mjekësisë familjare Prishtinë	40,000	15,000	75,000	3,000
14	Trafiku Urban	3,600,000	-	-	-
15	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	53,000	400	9,200	-
16	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	32,000	2,000	-	28,000
17	KK Deçan	2,000	833	10,000	833
18	KK Gjakovë	150,000	-	747,000	25,000
19	KK Istog	6,139	722	5,056	1,083
20	KK Junik	6,667	4,000	13,333	267
21	KK Klinë	15,000	3,750	7,500	1,125
22	KK Pejë	255,000	810,000	-	27,000

|||||


|||||


23	Spitali Regjional Gjakovë	84,583	-	99,083	26,583
24	Spitali Regjional Pejë	19,444	15,556	-	1,556
25	Shërbimi i Shëndetit Mendor Gjakovë	7,222	-	7,222	7,222
26	Shërbimi i Shëndetit Mendor Pejë	6,222	889	17,778	2,667
27	Instituti i Mjekësisë së Punës Kosovë-Gjakovë	8,458	2,417	-	1,208
28	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Pejë	389	-	2,722	1,556
29	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës- Gjakovë	194	-	-	778
30	KRM Çabrati - Gjakovë	295,275	-	-	13,020
31	KK Dragash	32,500	250	35,000	1,200
32	KK Malishevë	140,000	-	-	20,000
33	KK Mamushë	21,250	14,167	-	11,900
34	KK Prizren	120,556	9,722	631,944	9,722
35	KK Rahovec	93,000	4,500	300,000	24,000
36	KK Suharekë	40,000	4,000	62	6,000
37	Spitali Regjional Prizren	32,222	24,167	-	6,444
38	Shërbimi i Shëndetit Mendor Prizren	42	22	333	83
39	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës- Prizren	667	-	-	3,333
40	KK Ferizaj	180,000	360	3,000	120,000
41	KK Hani i Elezit	107,667	7,083	-	14,167
42	KK Kaçanik	138,000	9,900	57,000	-
43	KK Shtërpc	3,556	-	-	6,516
44	KK Shtime	42,550	18,032	39,667	-
45	Spitali Regjional Ferizaj	87,500	37,500	200,000	12,500
46	Shërbimi i Shëndetit Mendor Ferizaj	11,278	6,444	20,944	3,222
47	Shërbimi i Shëndetit Mendor Shtime	9,000	3,000	-	4,500


|||||

48	Instituti Kombëtar i Shëndetetit Publik të Kosovës- Ferizaj	611	-	4,278	2,078
49	KK Gjilan	60,000	-	-	22,500
50	KK Kamenicë	105,000	4,500	17,000	12,500
51	KK Kllokot	32,500	-	-	17,500
52	KK Novobërdë	58,000	1,611	10,000	806
53	KK Partesh	54,000	-	-	3,600
54	KK Ranillug	45,000	-	-	28,110
55	KK Viti	180,000	-	-	7,500
56	Spitali Regjional Gjilan	24,800	3,358	50,000	15,000
57	Shërbimi i Shëndetit Mendor Gjilan	7,500	3,000	16,500	3,750
58	Instituti Kombëtar i Shëndetetit Publik të Kosovës- Gjilan	30,556	-	15,000	122
59	TrainKOS	1,200,000	-	-	-
60	Lotaria e Kosovës	3,500	-	-	-
61	KK Mitrovicë	75,000	45,000	360,000	6,000
62	KK Skenderaj	200,000	-	-	40,000
63	KK Vushtrri	206,667	15,500	157,583	19,375
64	KK Leposaviq	-	-	17,500	-
65	KK Zubin Potok	48,000	-	15,000	6,000
66	KK Zveqan	22,000	-	-	-
67	Spitali Regjional Vushtrri	3,000	6,000	150,000	3,000
68	Spitali Regjional Mitrovica	90,000	12,000	450,000	3,000
69	Shërbimi i Shëndetit Mendor Mitrovicë	4,800	1,500	36,000	5,400
70	Instituti Kombëtar i Shëndetetit Publik të Kosovës- Mitrovicë	722	-	5,056	2,889
71	Kompania regjionale e mbeturinave "UNITETI" Mitrovicë	690,000	-	-	-
<b>Totali</b>		<b>10,058,236.56</b>	<b>1,274,966.66</b>	<b>4,605,123.08</b>	<b>809,723.34</b>

Tabela 3.0 Sasitë e parashikuara për blerje për 36 muaj







■ Diesel për vetura dhe mjete tjera levizëse (10ppm)  
 ■ Diesel për ngrohje (10ppm)


■ Diesel për gjenerator (10ppm)  
 ■ Benzinë për vetura dhe gjeneratorë (10ppm)









**LOT 6 – MITROVICËS**

Numri i artikullit	Njësia matëse	Përshkrimi	Sasia e përafërt
1	Litër	Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10ppm	1,340,188.89
2	Litër	Diesel për gjeneratorë 10ppm	80,000.00
3	Litër	Diesel për ngrohje 10ppm	1,191,138.89
4	Litër	Benzinë për vetura dhe gjeneratorë 10ppm	65,663.89

**Tabela 5.0 Sasi të përafërta të furnizimeve për 36 muaj sipas Lot - eve**

Specifikimet teknike të kualitetit të produktit, janë përpiluar konform Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2012 të aprovuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me datën 27.04.2012<sup>6</sup>, i cili përcakton kualitetin e derivateve që janë të lejuara të importohen në Kosovë. Këto specifika adresojnë kualitetin e derivateve si në vijim:

- Specifikimi teknik për diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse - 10 ppm, diesel për gjenerator -10 ppm, diesel për ngrohje - 10 ppm)
- Specifikimi teknik petrol 95 dhe 98 (Benzinë për vetura -10 ppm)

Në vijim, AQP-ja ka përfshirë edhe kërkesat e përgjithshme:

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, kërkon që Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin. No. 05/L-092. LPP.<sup>7</sup>

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit-kopje
- Certifikata e TVSH-kopje
- Certifikata e numrit fiskal-kopje
- Kopje të noterizuara të Licencave për shërbime në sektorin e karburanteve:
  - Licencën e importit,
  - Licencën e shitjes me shumicë,
  - Licencën e transportit dhe
  - Licencën e shitjes me pakicë për pikat e karburantit ku Operatori Ekonomik ofron furnizime me derivate e te cilat i ka në pronësi apo te marra me qira.

6 <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/A4DDA757-A8F1-47D5-AA71-52235184A217.pdf>  
7 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>



**TË GJITHA LICENCAT** e lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet që të kenë afat të validitetit. Për pikat e karburantit që priten të nënkontraktohen, Licencat e shitjes më pakicë dhe marrëveshjet për nën kontraktim duhet të dorëzohen nga Operatori Ekonomik që propozohet që të shpërblehet me kontratë në afat prej 7 dite nga kërkesa e Autoritetit Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës

*Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare*, ku Operatori Ekonomik është kërkuar të prezantoj Deklaratat Vjetore Tatimore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të cilat dëshmojnë se OE ka pasur një qarkullim vjetor jo më pak se vlerat e paraqitura në tabelën më poshtë për secilin nga Lot-et që dorëzon ofertën.

<b>Lot 1</b> 9,000,000.00 Euro	<b>Lot 4</b> 1,600,000.00 Euro
<b>Lot 2</b> 3,800,000.00 Euro	<b>Lot 5</b> 1,600,000.00 Euro
<b>Lot 3</b> 2,200,000.00 Euro	<b>Lot 6</b> 3,800,000.00 Euro

**Tabela 6.0 Kërkesat për qarkullim vjetor sipas Lot-eve**

Nëse analizojmë kërkesën e mësipërme për periudhën e qarkullimit financiar të kërkuar, vërejmë se AQP-ja nuk ka kërkuar qarkullim për 3 vitet e fundit, mirëpo ka caktuar vitet 2014, 2015 dhe 2016 që nënkupton se nuk ka marrë parasysh periudhën e qarkullimit për vitin 2017 – periudhë para datës së publikimit të fundit të njoftimit për kontratë. Kjo kërkesë ka mundur të paraqesë pengesë për operatorët ekonomik të rinj në treg për shkak se një periudhë prej gati 6 mujore e qarkullimit nuk është marrë parasysh për përmbushjen e kriterit të qarkullimit financiar.

*Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:*

- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj një listë të pikave të shitjes se karburanteve që planifikon për t'i shfrytëzuar për realizimin e kontratës. Vendet e pikave të shitjes, të cilat kërkohen janë të specifikuar në Aneksin 9;
- Tenderuesi duhet ta dorëzoj Certifikatën e cilësisë së mallrave të ofruara nga një Institucion i Pavarur për Certifikim të Cilësisë

Sipas kërkesave të përgjithshme operatori ekonomik, duhet të ofroj lokacionet e pikave të shitjes për Lot-et që oferton. Pikat e shitjes mund të jenë në pronësi të operatorit, të marrura me qira apo të nënkontraktuara.



|||||

<b>Regjioni 1</b>	<b>Lokacionet</b>	<b>Regjioni 4</b>	<b>Lokacionet</b>
	1 KK Drenas		1 KK Ferizaj
	2 KK Fushë Kosovë		2 KK Hani i Elezit
	3 KK Graçanice		3 KK Kaçanik
	4 KK Lipjan		4 KK Shterpcë
	5 KK Obiliq		5 KK Shtime
	6 KK Podujeve		
	7 KK Prishtine		
<b>Regjioni 2</b>	<b>Lokacionet</b>	<b>Regjioni 5</b>	<b>Lokacionet</b>
	1 KK Deçan		1 KK Gjilan
	2 KK Gjakovë		2 KK Kamenicë
	3 KK Istog		3 KK Klllokot
	4 KK Junik		4 KK Novo Berd
	5 KK Klinë		5 KK Partesh
	6 KK Peje		6 KK Ranillug
			7 KK Viti
<b>Regjioni 3</b>	<b>Lokacionet</b>	<b>Regjioni 6</b>	<b>Lokacionet</b>
	1 KK Dragash		1 KK Mitrovice
	2 KK Malisheve		2 KK Skenderaj
	3 KK Mamushe		3 KK Vushtrri
	4 KK Prizren		4 KK Leposaviq
	5 KK Rahovec		5 KK Zubin Potok
	6 KK Suhareke		6 KK Zveqan

**Tabela 7.0 Vendet e pikave të shitjes të cilat kërkohen me kontratë.**

|||||

|||||

*Siguria e tenderit* – Shuma e Sigurimit të tenderit në bazë të Lot-it në të cilën oferton operatori ekonomik duhet të jetë në vlerën si në tabelën vijuese, ndërsa periudha e kohëzgjatjes duhet të jetë 150 ditë prej datës së pranimit të ofertave.

<b>Lot 1</b>	140,000.00 Euro	<b>Lot 4</b>	25,000.00 Euro
<b>Lot 2</b>	55,000.00 Euro	<b>Lot 5</b>	25,000.00 Euro
<b>Lot 3</b>	35,000.00 Euro	<b>Lot 6</b>	55,000.00 Euro

**Tabela 8.0 Shuma e sigurisë së tenderit sipas Lot-eve.**

*Siguria e ekzekutimit* - Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me kohëzgjatje prej 37 muaj prej datës së nënshkrimit të kontratës. Shuma e kërkuar për siguri të ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me kohëzgjatje 37 muajshe. Pas vendimit të OSHP-së për rritjen e vlerës së sigurisë së ekzekutimit, Autoriteti Kontraktues kishte obliguar tenderuesit fitues të Lot-eve 1, 2 dhe 3 që siguria e ekzekutimit të ngritet nga 10% në 15% të vlerës së kontratës. Në tabelën për ndërtimin e çmimeve, AK-ja ka specifikuar parametrat për shfrytëzim në ndërtim të çmimeve, të cilat karakterizohen në fikse dhe variabile.

Nr.	Pershkrimi	Norme fikse/variabile
1	Berza mesatare mujore CIF Med (Genova/Lavera Ton/\$)	Variabile
2	Kursi mesatar mujor \$/euro (variabile)	Variabile
3	Çmimi i tonit ne Euro (1X2)	Variabile
4	Shëndrrimi i tonit ne litër (fiks)	Fikse – Një ton Diesel = 1,191 L Fikse - Një ton Benzinë = 1,368 L
5	Çmimi për litër ne euro (3/4) (Çmimi para taksave )	Variabile
6	Akciza për litër (fiks)	Fikse në bazë të normës të përcaktuar nga Kodi Doganor dhe Akcizave
7	GJITHSEJ (5+6)	Variabile
8	Premiumi i kompanisë / litër sipas ofertës dhe kontratës	Fikse
9	Gjithësejt çmimi me Premium (7+8)	Variabile
10	TVSH 18% / litër	Fikse në bazë të normës të përcaktuar nga Ligji për TVSH
11	Çmimi për litër për faturim (9+10)	Variabile

**Tabela 9.0 Tabela informuese për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve**

|||||

|||||

AQP-ja, në tabelën për formimin e çmimit, fillimisht ka paraqitur edhe dy norma fikse Premiumin nga Rafineritë dhe Transportin, mirëpo pas ankesës nga operatori ekonomik Ip-Kos Sh.p.k, se këto norma të paracaktuara: Premiumi i Rafinerisë 50 USD si dhe Transporti 500 euro, janë në kundërshtim me Nenin 1, 6, 7, 51 dhe 52 të LPP-së, për shkak se këto norma të paracaktuara si fikse në të vërtetë janë të ndryshme për operatorët ekonomik në varësi nga vendi i furnizimit. Këto dy elemente të formimit të çmimit duhet të mos përfshihen në tabelën e formimit të çmimeve, mirëpo tenderuesi duhet t'i përfshijë në premiumim e ofertuar<sup>8</sup>. Këtë ankesë AQP-ja e ka trajtuar si të bazuar si dhe ka larguar nga Tabela për Formimin e Çmimit, Premiumin nga Rafineria dhe Transportin. Meqenëse këto dy kosto, tani do të mbulohen nga operatorët ekonomik, premiumi për litër i ofertuar nga tenderuesit tani pritej të ishte më i lartë për dallim nga aktivitetet e kaluara të prokurimit për furnizim me karburante të ndërmarra nga AQP-ja.

Në bazë të certifikatave të cilësisë së karburanteve të ofruara nga tenderuesit në dosjet e tyre të tenderit, mund të vërehet edhe origjina dhe vendi i furnizimit të tenderuesve, i paraqiturë si më poshtë.

Lot	Ofertuesi	Vendi i Furnizimit
1	Petrol Company	OKTA Maqedoni
2	DHF & Standard Benz	OKTA Maqedoni
3	Delta Group	OKTA Maqedoni
4	Hib Petrol	OKTA Maqedoni, NIS Naftgas Serbi, Coral AE Greqi
5	Fer Petrol & Lab Oil	OKTA Greqi

**Tabela 10.0 – Vendi i furnizimit sipas ofertuesve**

Sipas disa intervistave me OE, premiumet e rafinerive variojnë nga USD 45.00 deri në USD 75.00 për Ton, dhe po ashtu çmimi i transportit për litër varion nga 0.0167 €/Litër për furnizimet nga Maqedonia, dhe 0.0333/Litër për furnizimet nga Greqia, Bullgaria apo Shqipëria.<sup>9</sup>

8 Vendim për shqyrtimin e ankesave, AQP 27.12.2016  
9 Paraja publike apo konkurrenca, KDI 2015

|||||

# VLERËSIMI I OFERTAVE

AQP-ja, ka publikuar njoftimin për kontratë - Furnizim me Karburante me datën 01 Dhjetor 2016, pas publikimit të njoftimit, operatorë ekonomik Hib Petrol Shpk dhe Ip-Kos Sh.p.k, parashtrojnë kërkesë tek AQP-ja, ku kërkojnë ndryshimin e tabelës për formimin e çmimit dhe shtyrjen e afatit për dorëzimin e ofertave). AQP-ja, merr vendim që të ndryshohet tabela për formimin e çmimit, mirëpo nuk e aprovon kërkesën për shtyrje të afatit. Afati shtyhet për shkak të korrigjimeve në dosjen e tenderit. Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik Hib Petrol Sh.p.k nga AQP, operatori dorëzon ankesë në OSHP me datë 23.01.2017, ku kërkohet që: OSHP-ja të rivlerësojë kriteret e vendosura në dosjen e tenderit për shkak se kriteret janë të ulëta dhe nuk janë të vendosura sipas natyrës së aktivitetit të prokurimit, ndaj lejojnë krijimin e monopoleve dhe kompanive fantome. OSHP-ja merr vendim me të cilin ankesa e operatorit ekonomik Hib Petrol Sh.p.k aprovet si pjesërisht e bazuar dhe e obligon AQP-në, që lëndën ta kthej në ritenderim.

AQP-ja me datë 02.05.2017, bënë shpalljen e ritenderit në faqen elektronike të KRPP-së. Kundër këtij njoftimi, operatori ekonomik Hib Petrol Sh.p.k dorëzon ankesë në OSHP, nga e cila kërkon të rishikojë kriteret e dosjes së tenderit, pasi ato janë shumë të ulëta dhe mundësojnë ofertimin nga kompanitë joserioze. OE Hib Petrol, përmes ankesës kërkonte që në dosjen e tenderit të përfshiheshin edhe kriteret si: Autorizimi nga Prodhuesi, Referenca paraprake për kontrata të natyrës së ngjashme, Listën e Mjeteve Transportuese dhe Licenca për Deponim. Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimorë është i njëjtë, për të cilën paneli shqyrtues ka marrë vendim në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit me datë 28.02.2017.

Pas ankesave të sipërpërmendura, rrjedhimisht ndodhin vonesa të shumta, ku hapja e ofertave shtyhet deri në datën 03.08.2017.

Në përgjigje të këtij tenderi kishin ofertuar tetë kompani: Petrol Company, Konzorciumi DHF Company Sh.p.k dhe Standard Benz, Delta Group, IP-KOS Sh.p.k, Konzorciumi Fer Petrol dhe Lab Oil Sh.p.k, Petrol Oti Slovenia, Hib Petrol dhe Alfa Trade Sh.p.k.

Nr	Tenderuesi	Vendi	Lotet	Çmimi (Premiumi i kontratës)	Vërejtje
1	Petrol Company	Prishtinë	LOT I	666.6052	Jo
			LOT II	271.4351	
			LOT III	158.7085	
			LOT IV	115.0350	
			LOT V	114.6524	
			LOT VI	-	
2	DHF Company Sh.p.k dhe N.T Standard Benz	Pejë	LOT I	666.6052	Jo
			LOT II	271.4351	
			LOT III	158.7085	
			LOT IV	115.0350	
			LOT V	114.6524	
			LOT VI	-	

|||||

3	Delta Group	Pejë	LOT I		Jo
			LOT II	271.4351	
			LOT III	158.7085	
			LOT IV	115.0350	
			LOT V	114.6524	
			LOT VI	-	
4	Ip -Kos Sh.p.k	Prishtinë	LOT I	324,636.77	Jo
			LOT II	132,189.01	
			LOT III	-	
			LOT IV	-	
			LOT V	-	
			LOT VI	130,369.48	
5	Fer Petrol dhe Lab Oil Sh.p.k	Drenas	LOT I	520,466.33	Jo
			LOT II	211,939.35	
			LOT III	123,958.148	
			LOT IV	90,053.389	
			LOT V	89,607.20	
			LOT VI	208,936.67	
6	Petrol Oti Slovenia	Miradi e epërme	LOT I	656,606.18	Jo
			LOT II	247,277.57	
			LOT III	-	
			LOT IV	113,309.61	
			LOT V	-	
			LOT VI	-	
7	Hib Petrol	Ferizaj	LOT I	596,734.63	Jo
			LOT II	-	
			LOT III	-	
			LOT IV	102,111.79	
			LOT V	-	
			LOT VI	-	
8	Alfa Trade Sh..k	Skenderaj	LOT I	623,018.83	Jo
			LOT II	-	
			LOT III	-	
			LOT IV	107,394.90	
			LOT V	-	
			LOT VI	240,863.59	

**Tabela 11.0 – Ofertat e operatorëve ekonomik sipas Lot-eve<sup>10</sup>**

10 Proceverbali i Hapjes së Tenderit – Kontratë Kornizë për furnizim me karburante

|||||

|||||

Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Tenderëve, të datës 30.08.2018<sup>11</sup>, tenderuesit e rekomanduar për dhënie të kontratës sipas Regjioneve ishin:

LOT	Regjioni	Emri i Tenderuesit të suksesshëm	Çmimi - Premiumi i Kontratës
1	Regjioni i Prishtinës	Petrol Company Sh.p.k	666.6052
2	Regjioni i Pejës	Grupi i Operatorëve Ekonomik – DHF Company Sh.p.k dhe Standard-Benz Sh.p.k	271.4351
3	Regjioni i Prizrenit	Delta Group Sh.p.k	158.7085
6	Regjioni i Mitrovicës	Ip - Kos Sh.p.k	130,369.48

**Tabela 12.0 – Identifikimi i tenderuesve të rekomanduar dhënie të kontratës<sup>12</sup>**

Lista e çmimeve të operatorëve ekonomik fitues për Lot 1,2,3 dhe 6 ishte:

#### Lot 1 – Petrol Company:

Nr.i artikullit	Njësia matëse	Përshkrimi	Sasia e përafërt për 36 muaj	Premiumi për një litër në Euro	Totali i vlerës së premiumit
1	Litër	Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10PPM	5,100,200.00	0.0001	510.020
2	Litër	Diesel për gjenerator 10PPM	205,183.33	0.0001	20.518
2	Litër	Diesel për ngrohje 10PPM	1,103,561.11	0.0001	110.3561
4	Litër	Benzin për vetura/gjenerator 10 PPM	257,108.33	0.0001	25.7108
					<b>666.60528</b>

#### Lot 2 – DHF Company dhe Standard Benz

Nr.i.arti-kullit	Njësia matëse	Përshkrimi	Sasia e përafërt për 36 muaj	Premiumi për një litër në Euro	Totali i vlerës së premiumit
1	Litër	Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10PPM	856,594.44	0.0001	85.6594
2	Litër	Diesel për gjenerator 10PPM	838,166.67	0.0001	83.8166
2	Litër	Diesel për ngrohje 10PPM	909,694.44	0.0001	90.9694
4	Litër	Benzin për vetura/gjenerator 10 PPM	109,897.78	0.0001	10.9897
					<b>271.4351</b>

11 Raporti i ekspertit shqyrtues, 16.10.2017

12 Procesverbali i Hapjes së Tenderit – Kontratë Kornizë për furnizim me karburante

|||||



|||||

### Lot 3 – Delta Group

Nr.i.arti-kullit	Njësia matëse	Përshkrimi	Sasia e përfaqëruar për 36 muaj	Premiumi për një litër në Euro	Totali i vlerës së premiumit
1	Litër	Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10PPM	480,236.11	0.0001	48.0236
2	Litër	Diesel për gjenerator 10PPM	56,827.78	0.0001	5.6828
3	Litër	Diesel për ngrohje 10PPM	967,339.78	0.0001	96.7340
4	Litër	Benzin për vetura/gjenerator 10 PPM	82,683.33	0.0001	8.2683
					158.7087

### Lot 6 – Ip Kos Sh.p.k

Numri i artikullit	Njësia matëse	Përshkrimi	Sasia e përfaqëruar	Premiumi për një litër në Euro	Totali i vlerës së premiumit
1	Litër	Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10ppm	1,340,188.89	0.0487	65,267.20
2	Litër	Diesel për gjeneratorë 10ppm	80,000.00	0.0487	3,896.00
3	Litër	Diesel për ngrohje 10ppm	1,191,138.89	0.0487	58,008.46
4	Litër	Benzinë për vetura dhe gjeneratorë 10ppm	65,663.89	0.0487	3,197.83
					130,369.49

#### Tabela 13.0 Lista e çmimeve të operatorëve ekonomik

Për Lot-in 4 dhe Lot-in 5 nuk ishte rekomanduar asnjë operator për dhënie të kontratës me arsyetimin se çmimi i ofruar ishte më i lartë se 10%, e çmimit për litër të ofertës së përgjegjshme më të ulët të ofertuar. Sipas sqarimit të paraqitur në Aneksin 10 të dosjes së tenderit këto çmime do të konsiderohen si çmime jo të tregut apo të larta dhe oferta do të refuzohet.<sup>13</sup> Gjatë vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se operatori ekonomik IP-KOS Sh.p.k në ofertën e vet ka ofruar sigurimin e tenderit 150 ditë nga data 16.06.2017. Ky sigurim ka qenë i vlefshëm deri me datën 16.11.2017. Në kohën e dorëzimit të ofertës, vlefshmëria e sigurimit ka qenë në pajtim me FDT-në, por si rezultat i ndryshimit të datës së hapjes së tenderëve për shkak të ankesave nga tenderuesit në OSHP, shihet se vlefshmëria e këtij sigurimi nuk është më 150 ditë nga data e hapjes së tenderëve 03.08.2018. AQP-ja e ka trajtuar si të përmbushur këtë kërkesë bazuar në interpretimin e KRPP-së të datës 23.08.2017 lidhur me Sigurimin e Tenderit në fjalë.

Duke u bazuar në premiumet për litër të ofruar nga operatorët ekonomik Petrol Company prej 0.0001 €/L për Lot 1, operatori ekonomik DHF Company dhe Standard Benz prej 0.0001 €/L për Lot 2 dhe Delta Group prej 0.0001 €/L për Lot 3. AQP konsideron se tenderi është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe dërgon Letër standarde për kërkesë për

|||||

|||||

informata mbi tenderët jonormalisht të ulët tek këta operatorë ekonomik ku kërkohet të sqarohet vlera e premiumit të ofruar. Petrol Company me datë 15.08.2017 kishte ofruar sqarimet në lidhje me tenderët jonormalisht të ulët duke deklaruar se kompania është një ndër kompanitë më të mëdha në tregun e furnizimit me karburante në Kosovë, ndaj përfiton nga beneficionet që rafineritë ofrojnë për blerësit e mëdhenj si: rabatet mujore, rabatet vjetore, shpenzime më të ulëta të transportit për shkak se kompania posedon autobotet e veta, përfitimet nga përcjellja e çmimeve të berzës dhe shpenzimet më të ulëta të nënkontraktimi për shkak se kompania posedon pompat e saj dhe vetëm në komunën e Drenasit do të ketë nevojë për nënkontraktim.<sup>14</sup> Petrol Company, për këto pretendime të benefiteve nga rafineritë e naftës nuk kishte bashkangjitur kontrata me rafineritë apo dëshmi të tjera, të cilat do të evidentonin pohimet e rabatave vjetore 5USD, rabateve mujore 10USD, dhe rabateve në çdo faturë me parapagim 5 USD.

Grupi i operatorëve ekonomik DHF Company dhe Standard Benz me datë 15.08.2017 kanë dërguar sqarimet për tenderët jonormalisht të ulët, ku është deklaruar sa përfitimet nga rabatet nga rafineritë si dhe transporti vetjak do të mundësojë realizimin e kontratës me një fitim prej 27,100 Euro. Përfitimet nga rafineritë janë: Rabatet mujore dhe vjetore 7.00 USD, ndryshimi i çmimit të blerjes së derivateve me çmimin e bursës 3.25USD, ndryshimi në transport etj.

Operatori ekonomik Delta Group, gjithashtu ka ofruar sqarimet për çmimet jonormalisht të ulëta, sipas të cilave, kompania përfiton nga rabatet, nga rafineritë si dhe nga transporti vetjak i karburanteve.

AQP-ja, në bazë të sqarimeve të operatorëve ekonomik për tenderët jonormalisht të ulët merr vendim se këto sqarime janë të mjaftueshme për të arsyetuar çmimin jonormalisht të ulët dhe njofton operatorët për dhënie të kontratës.

AQP-ja pranon si të bazuara sqarimet nga operatorët ekonomik për Lot-in 1, 2 dhe 3 për implementimin e kontratave dhe me datën 15.09.2017 publikon njoftimin për dhënie të kontratës këtyre tenderuesve.

Kundër këtij njoftimi, operatorët ekonomik: Hib Petrol Sh.p.k, Fer Petrol & Lab Oil Shpk dhe Alfa Trade kishin dorëzuar kërkesën për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues me arsyen se AQP-ja nuk i kishte trajtuar kujdesshëm tenderët jonormalisht të ulët si dhe nuk kishte respektuar kërkesat e dosjes së tenderët për afatet e sigurimit të tenderit të dorëzuara nga tenderuesit.

AQP-ja, në përputhje me nenin 108/A, paragrafi 10.1, refuzon kërkesat e dorëzuara për shqyrtim si të pabazuara, me arsyetimin se kriteret e dosjes së tenderit janë në përputhje me LPP-në. Sigurimi i ofertës të OE Ip Kos Sh.p.k, është sipas kërkesës së DT-së, bazuar në interpretimin e KRPP-së. AQP-ja ka zbatuar rregullat për tender jonormalisht të ulët dhe me sqarimet e dhëna nga operatorët ekonomik është bindur se OE-të e rekomanduara për kontratë mund ta implementojnë kontratën.

Pasi kërkesat e tenderuesve refuzohen si të pabazuara nga AQP, tenderuesit "Fer Petrol dhe Lab Oil", "Alfa Trade Sh.p.k" dhe "Hib Petrol Sh.p.k" deponojnë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Grupi i operatorëve ekonomik Fer Petrol dhe Lab Oil kishte paraqitur ankesë në OSHP, sipas së cilës, për Lot-in 4 dhe 5, AQP-ja e ka eliminuar operatorin ekonomik duke u bazuar në kriteret, të cilat nuk janë pjesë e FDT-së dhe pjesë e njoftimit për kontratë. AQP-ja eliminon operatorin ekonomik duke u bazuar në një çmim të tregut i cili është i parregullt. Po ashtu, AQP-ja nuk i trajton kujdesshëm tenderët jonormalisht të ulët sipas Nenit 42 dhe sipas rregullores për tenderët JoNormalisht të ulët, formulari B57<sup>15</sup>. Pikë tjetër e ankesës ishte edhe dhënia e kontratës operatorit ekonomik Ip-Kos Sh.p.k për Lot-i 6, ku AQP-ja kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik, i cili nuk kishte plotësuar kushtin prej 150 ditëve nga data e dorëzimit të tenderëve, ndaj kishte kërkuar nga OSHP-ja që ta kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik<sup>16</sup>. Në raportin e tij të datës 16.10.2017, eksperti shqyrtues i jashtëm profesional i autorizuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, konstaton se AQP-ja ka vepruar sipas kriterit të

14 Sqarim i çmimit jo-normalisht të ulët nga Petrol Company për AQP, 15.08.2017

15 Ankesa në OSHP ,numër 365/17 e datës 02.10.2017 nga Fer Petroll dhe Lab Oil

16 Ankesa në OSHP ,numër 365/17 e datës 02.10.2017 nga Fer Petroll dhe Lab Oil

|||||

çmimit më të lirë, por nuk ka analizuar ofertat e tyre sipas çmimit të tregut dhe nuk ka bërë vlerësimin e ofertës sipas Nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave për tenderë jonormalisht të ulët (B57 versioni i korrigjuar) dhe ky pretendim i OE-së ankuese është i bazuar sipas nenit 61 të LPP-së.

Gjithashtu edhe pretendimi ankimor nga ankuesi se operatori i përzgjedhur për dhënie të kontratës Ip-Kos Sh.p.k nuk e kishte plotësuar kriterin për afatin e sigurimit të tenderit është i bazuar dhe i propozon Panelit Shqyrtues që Autoriteti Kontraktues ta kthejë lëndën në rivlerësim<sup>17</sup>.

OE Alfa Trade si palë e pakënaqur me njoftimin e AK-së për dhënie të kontratës kishte parashtruar ankesë tek OSHP-ja ku kishte potencuar se sqarimet për tenderët jonormalisht të ulët të paraqitur nga OE fitues për Lotet 1,2 dhe 3 ishin të pa baza dhe nuk qëndronin.

Sipas OE Alfa Trade, transporti nga pika më e afërt e ngarkimit – Durrësi, për ato kompani të cilat kanë autobote, ka kosto prej 1.5 Cent/Litër e dokumentuar nga Dogana e Kosovës, baza e transportit 350 Euro plus 18% TVSH, gjithsejtë transporti për autobot 413 Euro. Edhe për arsyetimin nga operatorët ekonomik se fitojnë në çmim duke blerë sasi të mëdha dhe duke bllokuar sasi të kur çmimi është i ulët, OE Alfa Trade kishte sqaruar se deponimi i sasive të mëdha të naftës sjellë kosto shtesë që variojnë nga 25-35 USD për ton. Kosto shtesë janë edhe shpenzimet e portit detar për OE-të që furnizohen nga porti i Durrësit, 15 USD për ton apo 2 cent për litër. Po ashtu OE-të, të cilët kanë nënkontraktuar furnizimin në qytete ku nuk posedojnë pompa të derivateve, për çdo litër duhet të paguajnë komision prej 2 deri 3 cent për nënkontraktorin, i cili është shpenzim shtesë në realizimin e kontratës. Gjithashtu AQP, për Lot-4, ishte shpallur fitues OE në kundërshtim me kërkesat e Nenit 57 të Ligji i Prokurimit Publik, Sigurimi i Tenderit, paragrafët 2, 4.2 dhe 4.3 ku sigurimi i tenderit të operatorit ekonomik fitues Ip-Kos, nuk kishte validitet 150 nga data zyrtare e hapjes së tenderëve 03.08.2017<sup>18</sup>. Lidhur me pretendimet ankimore të OE Alfa Trade për dhënie të tenderit me çmim jonormalisht të ulët, eksperti shqyrtues profesional në raportin e tij të datës 16.10.2017 thekson se për dhënien e tenderëve me çmime jonormalisht të ulëta ka pyetur AQP-në dhe ka pranuar këtë arsyezim nga AQP: **“Kemi pyetur operatorët ekonomik sipas nenit 61 të LPP-së dhe na kanë bindur se mund të implementojnë kontratat”**. Eksperti shqyrtues më tutje thekson se: “AQP-ja është bindur sipas përgjigjeve të OE-ve dhe nuk ka aplikuar vlerësimin sipas Rregullave për tenderët jonormalisht të ulët. Pra me çmimin premium prej 0.0001 Euro për litër është e palogjikshme të kryhet furnizimi pasi që shpenzimet e rrymës, transportit, punëtorëve duhet të përfshihen në premiumin e tenderuesit si në Aneks 10 të dosjes së tenderit. Prandaj AQP-ja duhet ta respektoj nenin 61 të LPP-së dhe Nenin 42 të RrUOPP-së, ndaj të gjitha pretendimet ankimore janë të bazuara.”.

## **“TENDERUESI** ka ofruar çmim sipas të cilit, duhet të i shes 100 litra karburante (diesel ose benzinë) dhe të ketë një fitim prej 0.01 Euro (1 cent)” – Eksperti Shqyrtues

OE Hib Petrol, si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë tek OSHP-ja në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta, sipas së cilës “meqenëse shpenzimet e transportit dhe premiumi i rafinerisë së naftës janë paraparë të përfshihen në premiumin për litër të ofertuar nga operatorët ekonomik, kontratat e dhëna operatorëve për Lot 1, 2 dhe 3 me prime 0.0001 Euro/Litër nuk mund të realizohen pa pasur humbje kompanitë. Nuk mund të arsyetohen çmimet jonormalisht të ulëta sidomos kur operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk furnizohen direkt me shumicë nga rafineritë”. Hib Petrol kishte kërkuar nga AQP-ja që të rishikojë kalkulimin e çmimeve, formën e realizimit, koston e shpenzimeve dhe të rishqyrtojë çmimet e operatorëve ekonomik fitues për LOT 1, 2 dhe 3. Gjithashtu në ankesën e paraqitur pranë OSHP-së, operatori ekonomik Hib Petrol Sh.p.k deklaroi se vetëm

<sup>17</sup> Raporti i Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit për OSHP i datës 16.10.2018  
<sup>18</sup> Ankesa në OSHP, numër 371/17 e datës 06.10.2018 nga Alfa Trade Sh.p.k



shpenzimet administrative deri te nënshkrimi i kontratës arrijnë vlerën 50,000.00 Euro siç janë: Sigurimi i ofertës, noterizimi i dokumenteve, shpenzimet e fotokopjimit, shpenzimet e sigurimit të ekzekutimit, e që këto shpenzime nuk mund të mbulohen me çmimet për litër të ofertuara.

Bazuar në sqarimet e kompanive të rekomanduara për kontratë, nuk ka arsytim të cekur siç kërkohet në rregulloren e prokurimit publik për tenderët jonormalisht të ulët. Gjatë arsytimit të çmimeve të cilat janë konsideruar si jonormalisht të ulëta nga Autoritetet Kontraktuese, sipas nenit 61 të LPP-së, autoriteti kontraktues mund të marr parasysht si ekonominë e procesit të prodhimitarisë, zgjidhjet teknike dhe kushtet veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin. Elementet që lidhen me mos-pajtueshmërinë me rregullat për sigurinë, kushtet e punës apo punësimit mund të merren parasysht për të refuzuar një tender jonormalisht të ulët<sup>19</sup>.

## **“AQP-ja** institucion me kredibilitet dhe pozicion udhëheqës në Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës pranon sqarime për çmimin jo-normalisht të ulëta pa fakte, por vetëm merr për bazë deklaratatë” - Hib Petrol Sh.p.k

Sa i përket benefiteve siç pretendon operatori ekonomik Petrol Company, fitues i Lot-it 1, nuk qëndrojnë sepse OE-të fitues, furnizimet e deritanishme mbi 95% i kanë pasur nga rafineria OKTA AD (afersisht 19 milion litra diesel dhe benzin) dhe se vlera e furnizimeve të kompanisë fituese është shumë më e vogël se ajo e kompanisë sonë Hib Petrol Sh.p.k (95 milion litra diesel dhe benzinë).<sup>20</sup> Më tutje specifikohet edhe kontrata me rafinerinë OKTA, e cila i është bashkangjiturë ankesës nga tenderuesi Hib Petrol, ku specifikohen kushtet e benefiteve të cilat kompanitë përfitojnë në rast të blerjeve të mëdha, “premiumet e rafinerive, të prezantuara si të hyra në sqarimet për tenderët jonormalisht të ulët nuk qëndrojnë për shkak se premiumet e rafinerive janë kosto shtesë +23 USD mbi çmimin e bursës dhe jo minus, me kushtin që me këto çmime të furnizohen në Greqi e jo në Maqedoni. Në Maqedoni çmimi është më i lartë”.

Për të vërtetuar premiumet e rafinerive, operatori ekonomik i ka bashkangjitur ankesës edhe Dokumentet Unike Doganore – DUD. Më tutje në ankesë potencohet: “benefitet nga parapagimi nuk qëndrojnë sepse të gjitha pagesat duhet të bëhen me parapagim. Justifikimi i transportit nuk është logjik për shkak se një autobot ka shpenzime 35lt për 100km. Kjo nuk i arsyeton dërgesat nga Rafineria në Kosovë pa i llogaritur edhe dërgesat e furnizime deri tek autoriteti kontraktues”. Në ankesën e paraqitur, tenderusi Hib Petrol deklaroi se vetëm kostot e rafinerisë dhe transportit do të kalonin 0.03 Euro deri 0.035 euro shpenzime mbi çmimin e bursës. Ndaj ka kërkuar që institucioni i OSHP-së, të verifikojë me fakte pretendimet e operatorit ekonomik dhe jo sipas deklaratave apo pretendimeve për benefite nga rafineritë. Keto deklarata mund të verifikohen nëse janë të sakta duke kërkuar nga kompania të ofrojë Deklaratat Doganore ku paraqitet kostoja e blerjes së furnizimeve si dhe kostoja e transportit.

Kompania Hib Petrol ka kërkuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që Autoriteti Kontraktues ta anulojë shpalljen e fituesit dhe tenderi të kthehet në rivlerësim, duke pretenduar se kanë argumente për këtë.

Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore nga tenderuesi Hib Petrol Sh.p.k në lidhje me premiumet prej 0.0001 euro për litër janë të bazuara sipas nenit 61 të LPP-së dhe rregullave për tenderët jonormalisht të ulët. Gjithashtu, konstatohet se ankuesi Hib Petrol ka bashkangjitur kontratat e blerjes në OKTA dhe nuk janë ato rabate siç i paraqet operatori ekonomik i propozuar për kontratë. Pra premiumi prej 0.0001 euro për litër është një premium shumë i vogël për mbulimin e shpenzimeve.

19 Ankesa në OSHP, numër 374/17 e datës 06.10.2018 nga Hib Petrol Sh.p.k

20 Ankesa në OSHP, numër 374/17 e datës 06.10.2018 nga Hib Petrol Sh.p.k



Gjithashtu, eksperti shqyrtues ka konstatuar se operatori ekonomik është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyen se çmimet e ofruara nga tenderuesi janë mbi 10% më të larta sesa oferta e përgjegjshme, mirëpo çmimi i përgjegjshëm më i lirë është çmim jonormalisht i ulët, ndaj ankesa e Hib Petrol është e bazuar.

OSHP-ja lidhur me ankesat nga tenderuesit, me datë 14.11.2017 merr vendim të refuzohen si të pabazuara ankesat e operatorëve ekonomik Fer Petrol dhe Lab Oil, Alfa Trade Sh.p.k dhe Hib Petrol Sh.p.k lidhur me Lot-et 1, 2 dhe 3. Ankesat për këto Lot-e kishin të bënin kryesisht me dhënien e kontratave operatorëve ekonomik me çmime jonormalisht të ulëta, prej 0.0001 €/L. Edhe përkundër konstatimeve të ekspertit shqyrtues në raportin e tij se këto ankesa ishin të bazuara, OSHP-ja merr vendim me arsyetimin se AQP-ja në bazë të sqarimeve të dërguara nga tenderuesit e rekomanduar për kontratë është e bindur se kontratat mund të implementohen me këto çmime, ndaj OSHP-ja e vërteton njoftimin e dhënies së kontratës.

Për ankesat e tenderuesve për Lot-in 6, OSHP-ja i cilëson ankesat të bazuara dhe e obligon AQP-në që Lot-i 6 të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesat që kishin të bënin me Lot-in 4 dhe 5, ku AQP-ja nuk ka rekomanduar asnjë operatorë për dhënie të kontratës me arsyetimin se çmimi i ofruar ishte më i lartë se 10%, e çmimit për litër të ofertës së përgjegjshme më të ulët, ndaj këto çmime do të konsiderohen si çmime jo të tregut apo të larta. Prandaj ofertat do të refuzohen. Ankesat që kishin të bënin me këtë pikë ishin aprovuar si të bazuara dhe ishte obliguar AQP që Lot-et 4 dhe 5, të ktheheshin në rivlerësim.

Pas vendimit nga OSHP-ja, që AQP-ja të bëjë rivlerësimin e ofertave për Lot-et 4, 5 dhe 6, AQP-ja shpallë njoftimin për dhënie të kontratës me datë 14.12.2017. Për Lot-in 4 shpallë fitues tenderuesin Hib Petrol Sh.p.k me premium për litër të dieselit 0.0898 Euro dhe premium për litër të benzinës 0.0825 Euro apo me vlerë totale të premiumit të kontratës 102,111.79 Euro. Për Lot-in 5, shpallë fitues tenderuesin Fer Petrol dhe Lab Oil me premium për litër të dieselit 0.078 Euro dhe premium për litër të benzinës 0.080 Euro apo me vlerë totale të premiumit të kontratës 89,607.20 Euro, ndërsa për Lot-in 6 përsëri AQP-ja e shpallë fitues tenderuesin Ip-Kos Sh.p.k. me premium për litër të dieselit dhe benzinës prej 0.0487 Euro apo me vlerë totale të kontratës 130,369.48 Euro.

Përkundër konstatimeve nga eksperti shqyrtues i prokurimit se tenderuesi Ip-Kos Sh.p.k nuk e ka sjellur sigurimin e tenderit prej datës së hapjes 03.08.2017, por e ka paraqitur atë me datë 16.06.2017. Prandaj siguri në fjalë nuk e mbulon kërkesën e AK-së 150 ditë nga hapja. Poashtu përkundër vendimit nga OSHP-ja, i cili obligon rivlerësimin e ofertave për Lot-in 6 ku arsyetohet si e bazuar ankesa nga tenderuesit, AQP-ja përsëri e shpërblen me kontratë operatorin e papërgjegjshëm duke vonuar kështu procesin në tërësi dhe duke rrezikuar mbetjen pa furnizime me karburante për këtë regjion.


Kundër njoftimit për dhënie të kontratës pas rivlerësimit, përsëri operatorët ekonomik shtrojnë ankesë në OSHP, tenderuesi Alfa Trade Sh.p.k bënë ankesë kundër vendimit të AQP-së për dhënie të kontratës për Lot-in 6 tenderuesit Ip-Kos Sh.p.k, me arsyen e njëjtë se tenderuesi i shpallur fitues nuk është i përgjegjshëm, ngase nuk ka ofruar sigurimin e tenderit sipas afateve të kërkuara në dosjen e tenderit. Ankesë në OSHP, shtron edhe grupi i operatorëve ekonomik Fer Petrol dhe Lab Oil me arsyen e njëjtë për Lot-in 6 për dhënie të kontratës operatorit ekonomik të papërgjegjshëm.

OSHP pas pranimit të ankesave nga tenderuesit, me datën 12.02.2018 lëshon urdhëresë sipas së cilës autoriteti kontraktues – AQP, urdhërohet që ta respektoj vendimin e panelit shqyrtues të datës 31 Tetor 2017. Pas pranimit të urdhëresës, AQP-ja me datë 19.02.2018 shpallë njoftimin për dhënie të kontratës për Lot-in 6, grupit të operatorit Fer Petrol dhe Lab Oil Sh.p.k me premium të kontratës në vlerë prej 208,936.67 Euro, ndërsa Lot-i 5 shkon në ritenderim. Pas procesit të ritenderimit, kontrata për LOT-in 5 i jepet operatorit ekonomik Hib Petrol me premium për litër 0.001 për Diesel dhe Benzinë, apo me vlerë totale të premiumit të kontratës 2,033.21 Euro.

|||||

	Diesel - Premiumi €/L	Benzin - Premiumi €/L
LOT 1 - Premiumi €/L	0.0001	0.0001
LOT 2 - Premiumi €/L	0.0001	0.0001
LOT 3 - Premiumi €/L	0.0001	0.0001
LOT 4 - Premiumi €/L	0.0898	0.0825
LOT 5 - Premiumi €/L	0.0010	0.0010
LOT 6 - Premiumi €/L	0.0780	0.0800

Tabela 14.0 Premiumet për litër të kontraktuara sipas LOT-eve



Operatori Ekonomik	Vlera indikative e kontratës së nënshkruar	Fitimi i parashikuar - Premiumi total
Lot 1 - Petrol Company	5,743,150.11 €	666.61 €
Lot 2 - DHF & Standard Benz	2,338,656.26 €	271.44 €
Lot 3 - Delta Group	1,367,770.69 €	158.71 €
Lot 4 - Hib Petrol	1,111,554.69 €	102,111.79 €
Lot 5 - Hib Petrol	2,033,212.22 €	4,987.04 €
Lot 6 - Fer Petrol	2,551,872.73 €	208,936.67 €
<b>Gjithsej</b>	<b>15,146,216.70 €</b>	<b>317,132.25 €</b>


Tabela 15.0 Vlera e kontratave të nënshkruara dhe fitimi-premiumi i parashikuar sipas LOT-eve

|||||



Ky aktivitet i prokurimit shihet se nuk ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e bizneseve ashtu siç pretendohet roli i prokurimit publik në Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik 2017-2021, për shkak se nga vlera prej 11,482,789.28. Euro (Kontratat e nënshkruara për LOT 1,2,3 dhe 5), këto biznese kanë llogaritur të realizojnë një fitim prej 6,083.79 Euro, që nëse merren parasysh edhe kostot tjera që mund të ndodhin këto kompani do të operojnë me humbje, që është një veprim në kundërshtim me rolin e prokurimit publik në zhvillimin ekonomik kombëtar.

**Tabela – Vlerat dhe premiumet e kontraktuara sipas LOT-eve**










Si pjesë e menaxhimit të kontratës parashihet edhe menaxhimi i cilësisë së derivateve, ku Autoritetet Kontraktuese kanë të drejtë të kërkojnë inspektim të cilësisë së karburanteve, mirëpo deri më tani këtë të **drejtë nuk e kishin shfrytëzuar shumica e Autoriteteve Kontraktuese.**<sup>22</sup>

Kontrata në fjalë, përmban në vete edhe tabelën e përpilimit të çmimeve, të cilat kalkuloohen çdo fillim të muajit nga AQP-ja dhe publikohen në faqen zyrtare të AQP-së. Publikimi i këtyre çmimeve ka një rol të trefishtë, faturimin nga furnizuesi, planifikimin dhe përgatitjet nga Autoritetet Kontraktuese, si dhe njoftimi i publikut dhe palëve të tjera të interesit.

Në bazë të krahasimit të çmimit të produkteve: Diesel dhe Benzin, të paguar nga institucionet sipas çmimit mujor të ndërtuar me vendim nga AQP, si dhe në bazë të çmimeve mesatare të tregut të publikuara nga ASK del se në përgjithësi institucionet paguan çmime të cilat janë më të ulëta sesa mesatarja mujore e çmimeve të tregut, përpos në muajt prill dhe maj, për Lot-in 4 ishte paguar një çmim më i lartë për Diesel sesa çmimi i tregut për muajin prill që ishte paguar më shumë për 0.0011 €/L. Kurse për muajin maj ishte paguar më shumë për 0.0084 €/L.

Grafiku i mëposhtëm krahason çmimet e paguara nga institucionet shfrytëzuese të kësaj kontrate dhe çmimeve mesatare të tregut sipas Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuara nga ASK-ja.

**Çmimet e paguara nga AK-të krahasuar me çmimet e tregut - Diesel**




22 Intervista telefonike me Menaxherët e Kontratave





### Çmimet e paguara nga AK-të krahasuar me çmimet e tregut - Benzin



Nga grafikonet e mësipërme vërejmë se diferenca në mes të çmimeve të LOT 1, 2, 3 dhe 5 dhe çmimeve mesatare të tregut është e lartë. Çmimi në këto katër LOT-e është për një mesatare prej 13% më i ulët se çmimi i tregut, që është një fakt që tregon se këto LOT-e janë dhënë me çmime shumë më të ulëta sesa çmimet e tregut dhe do të duhej të trajtoheshin kujdesshëm si tender jonormalisht të ulët.

Sipas kushteve të kontratës, faturat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data kur kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Nga intervista me përfaqësuesin e operatorit ekonomik Petrol Company në lidhje me përmbushjen e obligimeve financiare nga Autoritetet Kontraktuese, u theksua se ka vonesa në realizimin e pagesave nga Autoritetet Kontraktuese.<sup>23</sup> Gjithashtu edhe përfaqësuesi i kompanisë Hib Petrol ka shprehur pakënaqësi në lidhje me vonesat në ekzekutimin e pagesave nga Autoritetet Kontraktuese.<sup>24</sup>

Vonesat në ekzekutimin e pagesave mbi 30 ditë janë shkelje e kushteve të kontratës dhe mund të sjellin rreziqe për Autoritetet Kontraktuese. Hyrja në obligime dhe nënshkrimi i kontratave pa u siguruar fondet e mjaftueshme mund të rezultojë në vonesa në zbatimin e kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara të cilat do të jenë barrë për AK-të për vitet e ardhshme. Gjithashtu, vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj operatorëve ekonomik. Në fazën e planifikimit të prokurimit, AQP-ja nuk kishte kërkuar nga AK-të deklaratën e disponueshmërisë së fondeve dhe kështu nuk ishte siguruar se AK-të kanë alokuar fondet për këto blerje. Me qëllim të eliminimit të këtyre vonesave, AQP-ja gjatë fazës së planifikimit të prokurimit duhet të kërkojë nga Autoritetet Kontraktuese deklaratat e disponueshmërisë së fondeve ku sigurohet se fondet janë alokuar apo ka fonde të mjaftueshme për të cilat ka siguri se do të alokohen në vitin fiskal.

Kjo kontratë është ende valide ende, andaj nuk kemi një vlerësim përfundimtar të performancës së kontratës. Gjithashtu kjo kontratë nuk është audituar nga auditori i përgjithshëm.

23 Intervistë me Fatos Shalën, AQP, me datën 23 Nëntor 2018

24 Fokus Grupi i organizuar nga KDI, me datën 30 Tetor 2018









## REKOMANDIMET PËR ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT

- Organi Shqyrtues i Prokurimit me vendimet e tij ofron zgjidhje për problemet dhe mosmarrëveshjet e paraqitura në procesin e prokurimit në tërësi, në mes të institucioneve publike dhe operatorëve ekonomik. Kualiteti i vendimeve të marra nga OSHP-ja përcakton dhe orienton Autoritetet Kontraktuese drejt vendimmarrjes në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik. KDI-ja rekomandon, që më qëllim ngritjes së cilësisë së vendimeve, OSHP-ja të konsiderojë opinionet e Ekspertit Shqyrtues dhe të sigurohet që vendimet të jenë në konsistencë me konstatimet e Ekspertit Shqyrtues dhe kundrejt situatave të njëjta.



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.  
Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy  
Pristina